



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI BASHKIAK KAMËZ

Nr. 154 prot.

Kamëz, më 20.11.2024

V E N D I M  
Nr. 113 .Datë 20/11 2024  
M B I

“MIRATIMIN E LISTËS SË SUBJEKTEVE, POSEDUES TË NDËRTIMEVE PA LEJE QË PREKEN NGA “NDËRTIMI I AMFITEATRIT DHE FUSHAVE SPORTIVE, KËNDIT TË LOJËRAVE DHE SHKALLËVE PANORAMIKE NË LIQENIN E PASKUQANIT DHE ZGJERIMI I RRUGËS “HAJRI SKEJA”, TË CILËT PËRFITOJNË SUBVENCIONIM TË QIRASË SIPAS PARASHIKIMEVE TË VKM NR. 409, DATË 15.06.2022 “PËR RREGULLAT, MËNYRAT DHE AFATET E TRAJTIMIT TË POSEDUESVE TË NDËRTIMEVE PA LEJE QË NUK LEGALIZOHEN”

Këshilli Bashkiak Kamëz i mbledhur sot me datë 20.11.2024, pasi mori në shqyrtim projekt-vendimin Nr.86 Datë 15.11.2024 në mbështetje të ligjit nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, Ligji nr.44/2015 “Kodi i Proçedurave Administrative së Republikës së Shqipërisë”; Ligji nr.22/2018 “Për strehimin social”i ndryshuar; Ligjit nr.20/2020 “Për përfundimin e proçeseve kalimtare të pronësisë në Republikën e Shqipërisë”; VKM nr.409, datë 15.06.2022 “Për rregullat, mënyrat dhe afatet e trajtimit të poseduesve pa leje që nuk legalizohen”; Urdhër i Kryetarit të Bashkisë Kamëz me nr.919, prot, datë 17.10.2024 dhe urdhër nr. 1048 Prot datë 08.11.2024 “Për mbledhjen e dokumentacionit dhe përgatitjen e dosjeve të subjekteve qe preken nga realizimi i projektit “Ndërtimi i amfiteatrit dhe fushave sportive, këndit të lojërave dhe shkallëve panoramike në liqenin e Paskuqanit dhe zgjerimi i rrugës “Hajri Skeja” Njësia Administrative Paskuqan; VKB nr.106, datë 24.10.2024 “Mbi miratimin e manualit të procedurave për rregullat, mënyrat dhe afatet e trajtimit të poseduesve të ndërtimeve pa leje që nuk legalizohen dhe që preken nga realizimi i projektit “Ndërtimi i amfiteatrit dhe fushave sportive, këndit të lojërave dhe shkallëve panoramike në liqenin e Paskuqanit dhe zgjerimi i rrugës “Hajri Skeja” Njësia Administrative Paskuqan; **Këshilli Bashkiak Kamëz**”;

V E N D O S I:

1. Miratimin e listës së subjekteve përfitues për bonus qiraje për 8 familje me vlerë mujore 196.000 (*njëqind e nëntëdhjetë e gjashtë mijë*) lekë që preken nga zbatimi i projektit “Ndërtimi i amfiteatrit dhe fushave sportive, këndit të lojërave dhe shkallëve panoramike në liqenin e Paskuqanit dhe zgjerimi i rrugës “Hajri Skeja” Njësia Administrative Paskuqan, dhe kanë nënshkruar Marrëveshjen e Bashkëpunimit me Bashkinë Kamëz, lidhur me projektin për interes publik të sipërcituar.
2. Subjektet përfitues do të trajtohen në formën e bonusit të qirasë për një afat 3-vjeçar nga momenti i firmosjes së marrëveshjes dhe lëshimit të godinës së banimit duke zbatuar



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI BASHKIAK KAMËZ

nivelin e qirasë për frymë sipas vendimit të *Këshillit Bashkiak nr.106, datë 24.10.2024* “Mbi miratimin e manualit të procedurave për rregullat, mënyrat dhe afatet e trajtimit të poseduesve të ndërtimeve pa leje që nuk legalizohen dhe që preken nga realizimi i projektit “Ndërtimi i amfiteatrit dhe fushave sportive, këndit të lojërave dhe shkallëve panoramike në liqenin e Paskuqanit dhe zgjerimi i rrugës “Hajri Skeja” Njësia Administrative Paskuqan, sipas përcaktimeve ligjore që bën VKM nr. 409 datë 15.06.2022.

3. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet grupi i punës i ngritur me urdhër të Kryetarit të Bashkisë me nr.919 prot. datë 04.10.2024 dhe urdhër nr. 1048 Prot datë 08.11.2024 “Për mbledhjen e dokumentacionit dhe përgatitjen e dosjeve të subjekteve që preken nga realizimi i projektit “Ndërtimi i amfiteatrit dhe fushave sportive, këndit të lojërave dhe shkallëve panoramike në liqenin e Paskuqanit dhe zgjerimi i rrugës “Hajri Skeja” Njësia Administrative Paskuqan .

Lista e subjekteve të cilët përfitojnë trajtimin financiar në formën e bonusit të qirasë paraqitet në aneksin bashkëlidhur këtij vendimi.

4 . Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimit të nenit 55, pika 6, të ligjit nr. 139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, të ndryshuar.

KRYETAR KËSHILLI  
Hysen KOLDASHI

